

RELACION PER DEGJESEN ME PUBLIKUN

SILDA SHPK

Aktiviteti i ketij subjekti do te jete prodhimi i kepuceve dhe aksesoreve pa proçese kimike (qepje, ngjitje, montim). Prodhimi i kepuceve dhe aksesoreve perfshihet ne veprimtarine e subjektit dhe i perputhet veprimtarise per te cilen eshte krijuar dhe zhvillon veprimtarine.

Lenda e pare vjen nga importi dhe kalon ne doganen shqiptare, i shoqeruar me çertifikate origjine per secilin produkt dhe ne menyre periodike ben bilancin e produkteve te çdoganuara me ato te kaluar ne produkt te gatshem dhe mbi bazen e nje proçes verbali me doganen ben rakordimin e mallit dhe mbetjetj e pa nevojshme ose kalojne ne asgjisimin e tyre ne vende te posaçme te cilat jane percaktuar me pare nga Bashkia.

Fazat kryesore te procesit te prodhimit jane:

Faza I: Magazinimi i mallit pasi behet importi e materialeve te gatshme te nevojshme per prodhim

Faza II: Prerja e lekures

Faza III: Pune pergatitore e cila ndahet ne dy procese skasim me makineri si dhe skajim me vijuzues ky proces behet manualisht.

Faza IV: Hedhja ne manovije per qepjen e kepuces dhe ngjitjen me mastic.

Faza V: Procesi i kontrollit te cilesise se suprinave te prodhuara dhe paketimi i tyre per eksportim.

Instalimet e perdorura jane:

1. Kompresor;
2. Makina qepese
3. Tranca;
4. Skajues
5. Manovij

Objekti ku zhvillohet veprimtaria eshte ndertuar per qellim industrial. Eshte me ndrçim te bollshem dhe hapësira te konsiderueshme per te kryer normalisht keto veprimtari.

Zona ku zhvillohet veprimtaria eshte nje zone historike industriale. Keshtu qe per funksionimin e ketij aktiviteti ne kete territor subjektit nuk i eshte dashur te beje ndryshime apo korrigjime te tjera ne lidhje me fuqine energjitike te instaluar apo rrjetin e kanalizimeve etj. Te gjithë permbushin kushtet e teknologjike per funksionimin normal te linjes se prodhimit.

Proçesi teknologjik karakteristikat e lendes se pare

Lekurerat me te rendesishme per sektorin e kepuceve jane:

- a. Lekura e viçit: a1) (indigjene prodhohen nga therja e kafsheve te kultivuara) a2) ekzotike (amerikane, aziatike, afrikane, australiane)
- b. Lekura dele dhe dhi (qe vjen nga pjesa veriore te Afrikes, Amerika, India dhe Kina dhe jane te pershtatshme per prodhimin e suprines dhe fodreve)
- c. Lekurat derri (projektuar veçanerisht per lekura per fodera)
- d. Lekurat e gjarper, reptilit dhe peshku (qe vijne nga vendet tropikale dhe jane perdorur, edhe me shkalle shume me te kufizuar, ne prodhimin e kepuceve per grate)

Lekura per suprinat duhet te jete e bute dhe kompakte, ndonjehere elastike, ne menyre qe te gjitha shtresat e formojne nje e tere dhe shtresa siperfaqe duhet te jete si nje trup i vetem. Nje lekure me cilesi gjithmone vjen nga nje trajtim i mire dhe nje fabrike lekuresh teknologjikisht te perparuara. Artikuj prej lekure te mire dhe terheqese jane ato qe lene ne funksion te karakteristikave, madje edhe ne prani te metat natyrore.

Pelhura te perdorura ne prodhimin e kepuceve mund te perdoren per ndertimin e suprines dhe rreshtim te brendshem jane te gjitha ne menyre adekuate perforcohet dhe kanavace panele. Para se te hyjne ne proçesin e prodhimit jane nenshtuar testeve laboratorike per te percaktuar rezistencen e tyre.

Subjekti ka vendosur makinerite e prodhimit me nje hapësire te hapur ku sipas proçesit jane radhitur makinerite . Linja e prodhimit konsiston ne repartet si:

1. Magazina e materialit te lendes se pare
2. Reparti i prerjes
3. Reparti i qepjes
4. Reparti i montimit (ngjitja, qepja)
5. Paketimi

Ne linjen e prodhimit jane punesuar rreth 200 punetore te gjitha gra ku nje pjese e mire jane dhe banore te zones dhe te gjitha jane te siguruar ne sigurimet shoqerore.

Subjekti punon me material te ardhur nga importi ku lenda e pare ka perfunduar proçesin e perpunimit kimik jashte vendit tone dhe gjithe materiali vjen i çertifikuar dhe me fatura doganore te preçizuara. Materialet qe vijne nga importi per linjen e kepuceve jane:

1. Lekure
2. Foder lekure
3. Astar sintetik

4. Kuti, fill qepje, nastro, qese plastike, perforcues

5. Mastic,

Pothuajse cdo proces kryhet me makineri qe punojne me energji elektrike dhe ne cdo mjedis jane instaluar ventilatore aspirimi.